



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”  
UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 4/132  
Datë: 30.12.2016

Mbështetur në nenin 210 deri 225 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Senati i Universitetit të Prishtinës miraton këtë:

**RREGULLORE**

**E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT  
NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS**

**Neni 1**

**Qëllimi**

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e mekanizmave dhe procedurave të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit në Universitetin e Prishtinës;
2. Kjo rregullore definon rolin dhe përgjegjësinë e njësive organizative dhe akademike në Universitet për realizimin e aktivitetave të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit;
3. Kjo rregullore definon mekanizmat dhe proceset, që përafrojnë Universitetin e Prishtinës me standarde e ENQA-s për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimit.

**Neni 2**

**Qëllimet e sistemit të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit**

1. Aktivitetet e vlerësimit realizohen për të identifikuar dhe promovuar praktikat e mira;
2. Aktivitetet e vlerësimit realizohen për të identifikuar elementet, që kërkojnë ndërhyrje për të përmirësuar gjendjen ekzistuese;
3. Aktivitetet e vlerësimit realizohen për të siguruar avancimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së Universitetit;
4. Aktivitetet e vlerësimit realizohen për të plotësuar kërkesat e sistemit të akreditimit në Kosovë, që janë fuqizuar nga Agjencia e Akreditimit në Kosovë.

**Neni 3**

**Lloji i vlerësimeve në kuadër të sistemit të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit**

1. Vlerësimet për qëllime të akreditimit institucional;
2. Vlerësimet për qëllime të akreditimit të programeve në nivel të njësive akademike.

#### **Neni 4**

##### **Akterët në sistemin e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit**

1. Senati i Universitetit;
2. Rektori;
3. Komisioni Qëndror i Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit në nivel të Universitetit;
4. Zyra për Zhvillim Akademik në nivel të Universitetit;
5. Dekani i Njësisë Akademike;
6. Komisioni për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësimit në nivel të Njësisë Akademike.

#### **Neni 5**

##### **Senati i Universitetit**

1. Senati është organi, që miraton Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit, si dhe anëtarët e Komisionit Qëndror të Cilësisë dhe Vlerësimit;
2. Senati miraton planifikimin për realizimin e aktiviteteve të sigurimit të cilësisë sipas propozimit të Komisionit Qëndror të Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit.

#### **Neni 6**

##### **Rektori**

1. Rektori sigurohet që ekzistojnë kushtet e duhura për realizimin e aktiviteteve të vlerësimit brenda sistemit të sigurimit të cilësisë.
2. Rektori sigurohet që ekziston mbështetja financiare e nevojshme për të realizuar aktivitetet e vlerësimit brenda sistemit të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit.
3. Rektori sigurohet që rezultatet e vlerësimeve të përkthehen në masa operative për përmirësimet e duhura dhe shpërblime për praktikat e mira.

#### **Neni 7**

##### **Komisioni Qëndror i Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit në Universitet**

1. Komisioni Qëndror i Sigurimit i Cilësisë, është komision këshillëdhënës i Senatit dhe përbëhet nga:
  - Prorektori për cilësi (ex-officio);
  - Zyrتari nga zyra për zhvillim akademik;
  - Deri në 8 përfaqësues të personelit akademik nga njësítë e ndryshme akademike;
  - 1 përfaqësues i studentëve, me notë mesatare mbi 8 dhe njoħuri të mira të gjuhës angleze.
2. Anëtarët e Komisionit, propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati për një mandat 4 vjeçar.
3. Së paku një e treta e anëtarëve të Komisionit Qëndror për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësimit, duhet të vazhdojnë në përbërjen e Komisionit pas mandatit 4 vjeçar për të siguruar vazhdimësinë e punës.

4. Komisioni Qëndror i Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit ka për detyrë:

- të hartojë udhëzuesin e aktiviteteve të vlerësimit të Sigurimit të Cilësisë;
- të hartojë instrumentet për vlerësim kualitativ dhe kuantitativ;
- të hartojë dhe shqyrtojë raportet e vlerësimit / vetëvlerësimit;
- të shqyrtojë raportet e vetëvlerësimit për akreditim institucional dhe të programeve;
- të shqyrtojë raportet e vetëvlerësimit për riakreditim institucional dhe të programeve në lidhje me nivelin e adresimit të çështjeve të ngritura nga AKA;
- të miratojë anëtarët e grupeve punuese për realizimin e vlerësimeve sipas nevojës;
- të udhëheqë procesin e publikimit të raporteve vlerësuese.

**Neni 8**

**Zyra për Zhvillim Akademik në Universitet**

1. Zyra për Zhvillim Akademik, administron proceset e vlerësimit sipas planifikimit të bërë.

2. Zyra për Zhvillim Akademik, menaxhon procesin e shpërndarjes dhe publikimit të raporteve të aktiviteteve vlerësuese.

3. Zyra për Zhvillim Akademik, ofron asistencë operative për Komisionin Qëndror të Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit.

4. Zyra e Zhvillimit Akademik, themelon Grupe Punuese, sipas rekomandimit të Komisionit Qëndror të Cilësisë dhe Vlerësimit në nivel të UP, për të realizuar aktivitetet e vlerësimit sipas nevojës.

**Neni 9**

**Dekani i Njësisë Akademike**

1. Dekani i Njësisë Akademike, sigurohet që koordinatori për zhvillim akademik kryen përgjegjësitë e veta në lidhje me realizimin e vlerësimeve në nivel Universiteti dhe në nivel të Njësisë Akademike sipas planifikimit të miratuar;

2. Dekani i Njësisë Akademike, siguron qasjen në të dhëna për vlerësimet, që bëhen në kuadër të kësaj Rregulloreje;

3. Dekani i Njësisë Akademike, sigurohet që aktivitetet e vlerësimit brenda njësisë përkatëse realizohen me sukses dhe sipas planifikimit;

4. Dekani i Njësisë Akademike, harton planin e përmirësimit pas secilit aktivitetet të vlerësimit dhe i reflekton masat, që duhet ndërmarrë në buxhetin vjetor të Njësisë Akademike.

**Neni 10**

### **Vlerësimi për akreditim institucional**

1. Universiteti i realizon aktivitetet e vlerësimit në mënyrë të vazhdueshme në fushat si vijon:
  1. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies;
  2. Vlerësimi i shërbimeve për studentë;
  3. Vlerësimi i aktivitetit shkencor dhe studimeve të doktoratës;
  4. Vlerësimi i shërbimeve administrative;
  5. Vlerësimi i bashkëpunimit ndërkombëtar;
  6. Vlerësimi i resurseve për mësimnxenie.
2. Të dhënat e vlerësimit të brendshëm shfrytëzohen për qëllime të akreditimit institucional të Universitetit, sipas dispozitatave të Agjencisë së Akreditimit të Kosovës dhe planifikimit të intervenimeve për përmirësim të veprimitarisë së Universitetit;
3. Vlerësimi i veprimitarive të Universitetit si në pikën 1 të këtij neni udhëhiqet nga Komisioni Qëndror i Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit në Universitet;
4. Procesin e vlerësimeve të veprimitarisë së Universitetit si në pikën 1 e administron Zyra për Zhvillim Akademik me ndihmën e koordinatorëve të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit, në njësitë akademike dhe grupit punues, i cili themelohet sipas nevojës.

### **Neni 11**

#### **Vlerësimi për akreditim të programeve të studimit në nivel të Njësisë Akademike**

1. Njësitë akademike në koordinim me Prorektorin/en për Sigurimin e Cilësisë dhe Zyrën për Zhvillim Akademik, udhëheqin procesin e akreditimit të programeve përmes Komisionit Qëndror të Sigurimit të Cilësisë në Komisionin e Studimeve, në nivel të Universitetit dhe Senat, sipas kërkesave të Agjencisë së Akreditimit të Kosovës.
2. Vlerësimi, që bëhet për akreditim të programeve duhet të përfshijë informacione për:
  1. Cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxenies;
  2. Cilësinë e veprimitarisë shkencore;
  3. Bashkëpunimin ndërkombëtar;
  4. Perceptimet e të diplomuarve për cilësinë e studimeve;
  5. Perceptimet e punëdhënësve për cilësinë e të diplomuarve;
  6. Cilësinë e shërbimeve për studentë;
  7. Cilësinë e kulturës organizative dhe menaxhimit.
3. Përveç dimensioneve të pikës 2 të këtij neni vlerësimi, që bëhet për akreditim të programeve duhet të merr për bazë edhe kriteret e tjera të specifikuara nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës.

### **Neni 12**

#### **Koha e realizimit të vlerësimeve**

1. Vlerësimi për akreditim të programeve i përshtatet dinamikës së akreditimit të programeve;
  - 1.1. Vlerësimi duhet të bëhet, së paku një herë në pesë vite, sipas planifikimit.
2. Vlerësimi për nevoja të përmirësimit të cilësisë i përshtatet dinamikës së akreditimit institucional me përjashtim të nevojës së identifikuar për vlerësimin jashtë këtij orari;
  - 2.2. Vlerësimi bëhet së paku një herë në pesë vite, sipas planifikimit.
3. Vlerësimi i mësimdhënies (kurseve) nga ana e studentëve bëhet në fund të secilit semestër.

### **Neni 13** **Shfrytëzimi i të dhënave të vlerësimit**

1. Të dhënat e vlerësimeve të parapara në këtë Rregullore, shfrytëzohen përgatitje të raporteve të vetëvlerësimit në kuadër të procesit të akreditimit institucional dhe të programeve;
2. Të dhënat e vlerësimit të parapara në këtë Rregullore, shfrytëzohen përgatitje të planifikimin vjetor dhe strategjik të Universitetit dhe prioritetizim të aktiviteteve zhvillimore;
3. Të dhënat e vlerësimit të parapara në këtë Rregullore, shfrytëzohen përgatitje të identifikimin e intervenimeve, që duhet të bëhen nga niveli i njësive akademike apo menaxhmentit qëndror për të adresuar çështjet me interes;
4. Të dhënat e vlerësimit të kurseve nga ana e studentëve, do të jenë në dispozicion të mësimdhënësve dhe menaxhmentit tënësive akademike dhe përdoren për qëllime tëpërmirësimit të performancës së mësimdhënies dhe avancimin akademik të personelit sipas kërkeseve statutare.

### **Neni 14** **Inicimi i vlerësimeve**

1. Komisioni Qëndror i Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit në Rektorat harton planin 5 vjeçar dhe planin e veprimit për secilin vit, që elaboron aktivitetet që ndërmerrin në secilin vit;
2. Plani 5 vjeçar miratohet nga Senati i Universitetit dhe është publik në web faqen e Universitetit;
3. Plani 5 vjeçar përfshin edhe aktivitetet vlerësuese të njësive akademike, ndërsa ato zhvillojnë planet e tyre përkatëse të detajuara të vlerësimeve;
4. Aktivitete shtesë të vlerësimit mund të iniciohen edhe në rastet kur një çështje adresohet nga palët relevante si Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, menaxhmenti i universitetit, Senati.

### Neni 15

#### Standardet dhe parimet e vlerësimit

1. Vlerësimet bëhen me qëllim të përmirësimit dhe jo paragjykimit;
2. Procesi i vlerësimeve bazohet në parimin e partneritetit të të gjitha palëve dhe akterëve të përfshirë;
3. Vlerësimet e realizuara në kuadër të sistemit të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit, bazohen në “Standardet dhe Udhëzimet Evropiane të Sigurimit të Cilësisë” të ENQA-s;
4. Raportet e aktiviteteve të vlerësimit do të bëhen publike me përjashtim të vlerësimit të kurseve individuale, të cilat mund të raportohen në formë të përbledhur dhe anonime.

### Neni 16

#### Dokumentet përcjellëse për implementim

1. Senati i Universitetit, me rekomandim të Komisionit Qëndror të Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit, miraton Udhëzuesin e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit;
2. Udhëzuesi i sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit, elaboron instrumentet për të dhënët kuantitative dhe kualitative për secilin vlerësim, si dhe procedurat, rolet e detajuara për secilën palë në realizimin e aktiviteteve të vlerësimit të parapara në këtë Rregullore.

Kryesues i Senatit të Universitetit të Prishtinës



Rektor i UP-së